

“DIGAT E ENERGJISË NUK JANË SHKAKU I PËRMBYTJEVE, NDIKOJNË POZITIVISHT”

Sa herë ka përmbytje, sidomos në zonën e Nënshkodrës, por së fundmi edhe në Myzeqe, një nga faktorët që përmendet në mënyrë të përsëritur janë shkarkimet nga digat e energjisë. Arjan Jovani President i ICOLD European Club (EURCOLD), që është Komiteti Ndërkombëtar i Digave të Mëdha ku Shqipëria është anëtare nga viti 1964 shprehet se shkaku i përmbytjeve është shumë më kompleks. Sipas tij, digat e energjisë në shumë raste shërbejnë si “mburojë” për prurje të jashtëzakonshme që në një rrjedhje natyrale do të shkaktonin dëme të mëdha. Ai sjell si shembull dy lumenj, Vjosën dhe Osumin, që kanë rrjedhje të lirë dhe që pak mund të bëhet në rastet e prurjeve të mëdha, ndërkohë që në rastin e Kaskadës së Drinit apo Devollit, shkarkimet e kontrolluara e bëjnë situatën më të menaxhueshme. Ai gjykon se problemi real i përmbytjeve që shkaktohen sot lidhet me bazën që është funksionimi i institucioneve, ku secili duhet të kryejë detyrat e tij, hartimi i studimeve dhe konsulencave konkrete për masat që duhen marrë dhe më pas kryerja e investimeve konkrete aty ku është urgjente dhe dëmi është më i madh.

Përmbytjet e fundit kthyen edhe një herë në vëmendje digat, kanalizimet, investimet. Cili është roli që kanë digat në vend dhe ndikimet e tyre sipas llojit?

Pjesa më e madhe e digave të mëdha në vendin tonë janë digat për ujti. Ekziston një rregull i përcaktuar si nga legjislacioni, ashtu edhe nga kërkesat e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM), sipas të cilit të gjitha digat e ujitjes duhet të zbrazen në muajin tetor, kur përfundon sezoni i ujitjes. Ato duhet të qëndrojnë të zbrazura deri në prill. Gjatë kësaj periudhe të kryhen mirëmbajtja dhe riparimet e nevojshme të elementeve kryesore të tyre si shkarkuesit, vepra e marrjes, etj. Duhet theksuar se digat e ujitjes në vendin tonë nuk janë ndërtuar për të zvogëluar efektin e përmbytjeve apo për kullimin e ujërave të tepërta. Për vetë madhësinë e rezervuarëve të krijuar prej tyre, ato mund të ndihmojnë shumë pak për zvogëlimin e efekteve të përmbytjeve. Për këtë arsye, KKDM ka miratuar rregullore që parashikojnë zbrazen e ujit nga rezervuarët deri në nivelin minimal të



lejuar nga projekti.

Ndryshe nga digat e ujitjes, digat që shërbejnë për prodhim hidroenergetik apo digat për furnizimin me ujë funksionojnë sipas rregulloreve specifike të cilat janë hartuar, me synimin kryesor në drejtim të sigurisë së digave dhe minimizimin e efekteve negative që shkaktohen gjatë dimrit nga prurjet e mëdha që vijnë në basenin e tyre ujor. Edhe pse këto digat përbëjnë vetëm rreth 7% të totalit të digave të mëdha në Shqipëri, ato janë digat më të mëdha që kanë krijuar rezervuarët më të mëdhenj dhe me ndikimin më të madh hidrologjik. Për shembull, për digat e kaskadës së lumit Drin funksionon Rregullorja e shkarkimit të plotave e vitit 1988, e cila përcakton në detaje veprimet që duhet të kryhen në periudhën Tetor - Mars, Prill - Maj dhe Qershor - Shtator.

Kjo rregullore është detyrim ligjor për KESH-in, ndërkohë që investitorët privatë kanë rregulloret e tyre të shfrytëzimit të miratuara nga KKDM si organ i Këshillit të Ministrave në sektorin e digave. Për shembull, Kompania Devolli HP ka hartuar rregullore të veçantë për shfrytëzimin e digave në kaskadën e Devollit, si dhe Planin e gatishmërisë në rastet e

emergjencave civile. Duhet theksuar se të gjitha rregulloret e shfrytëzimit të digave dhe rezervuarëve nga shfrytëzuesit e digave për prodhim hidroenergetik janë të miratuara nga KKDM. Pra, shfrytëzuesit e digave operojnë në mënyrë të kontrolluar dhe brenda kuadrit ligjor dhe kërkesave teknike për sigurinë e digave. Theksojmë se prurjet që shkarkohen nga sistemet e shkarkimit të digave gjatë periudhave të plotave nuk janë asnjëherë më të larta se prurjet natyrore që mund të sjell lumi.

Me fjalë të tjera, shkarkimet nga diga ndihmojnë në menaxhimin e prurjeve maksimale dhe në zvogëlimin e efektit të përmbytjeve që mund të shkaktohen prej tyre. Për këtë arsye, digat duhet të shihen si partnerë ndihmës në menaxhimin e përmbytjeve. Mjafton të shohim rastet e lumit të Vjosës apo të Osumit që janë lumenj pa diga, të cilët shkaktojnë përmbytje sa herë ka reshje të mëdha dhe mundësitë e menaxhimit të prurjeve të këtyre lumenjve janë minimale. Në këta lumenj deri më sot, masat merren vetëm pas ndodhjes së dëmit, jo për parandalim. Duhet theksuar se në këta lumenj është shumë e rëndësishme instalimi i stacioneve hidrologjike dhe meteorologjike, si dhe përpunimi i të dhënave të këtyre stacioneve në kohë reale nga ekspertët e shërbimit hidro-meteorologjik dhe Agjencia Kombëtare e Emergjencave Civile.

Menaxhimi i digave është mjaft kompleks ku ndërthuren shumë faktorë që janë të lidhur me fenomenet natyrore, por edhe me faktorin njeri. Ky kompleksitet është i vështirë të jetë i përsosur. Kundër natyrës nuk mund të fitosh, por përmes një menaxhimi dinamik të përgjegjshëm dhe profesional mund të ulësh pasojat e shkaktoara nga prurjet e mëdha hap pas hapi. Në këtë kontekst, digat duhen trajtuar si partnerë mbështetës, që jo vetëm se nuk kanë faj gjatë përmbytjeve, por na kanë ndihmuar në procesin e menaxhimit të përmbytjeve.

A janë në fakt shkarkimet arsyeja e përmbytjeve?

Përgjigjja ime është JO. Në situatën e ditëve të fundit nuk kanë qenë shkarkimet nga digat e hidroenergetikës arsyeja e këtyre përmbytjeve. Bazuar në të dhënat e regjistruara, rezulton se prurjet e ujit në kaskadën e lumit



Drin arritën 3800 m³/sek, në një kohë që sasia e shkarkuar nga HEC i Vaut të Dejës nuk ishte më e madhe se 1200 m³/sek. Duhet theksuar se gjatë kësaj periudhe problemi kryesor për rezervuarin e Fierzës ishin prurjet e ujit që erdhën nga Drini i Bardhë, i cili është një lumë i parregulluar dhe mbi të cilin nuk është ndërtuar asnjë digë. Nga Drini i Bardhë, që vjen nga Kosova nuk ka diga dhe reshjet e mëdha që bien në atë zonë krijojnë prurje të mëdha që shkarkohen direkt, brenda 24 orëve, në rezervuarin e HEC-it të Fierzës. Në këtë pellg shkarkohen përrenjtë e maleve nga zona e Pejës, që janë pjesë e Alpeve, deri në Prizren ku vijnë prurjet nga Malësia e Sharrit, dhe të gjitha këto derdhen në Drinin e Bardhë dhe përcillen menjëherë drejt rezervuarit të HEC Fierze.

Drini i Zi, që buron nga liqeni i Ohrit dhe gjatë kalimit në pjesën maqedonase menaxhohet përmes dy digave të mëdha në Spillje dhe Globocicë, kishte prurje të kontrolluara që nuk e kaluan sasinë prej 160 m³/sek.

Nga ana tjetër, HEC Koman, i cili ka një rezervuar me volum prej afro 5 herë më të vogël se HEC Fierzë, por përpunon prurje të mëdha të ujit që vijnë nga mbi 13 lumenj dhe përrenj, përfshirë zonat me reshjet më intensive të Alpeve tona siç janë Thethi, Valbona dhe Malësia e Pukës.

Në këtë rast, menaxhimi i koordinuar i prurjeve në Fierzë dhe Koman minimizoi ndjeshëm përmbytjet në pjesën e poshtme të lumit Drin në zonën e Nënshkodrës.

Kaskada e Drinit funksionon në bazë të rregullores së vitit 1988. A mendoni se ka nevojë për ndërhyrje për t’iu përshtatur kushteve të reja?

Në mendimin tim, pas afro 35 vitesh dhe ndryshimeve që kanë ndodhur si në drejtim të kushteve klimatike dhe menaxhimit të kaskadës, ka ardhur koha të përditësohen kërkesat e kësaj rregulloreje, duke pasur si fokus kryesor sigurinë e digave në këtë kaskadë. Kushtet klimatike kanë ndryshuar ndjeshëm në zonë, duke na përballur me prurje të mëdha

për një kohë të shkurtër dhe me frekuencë më të shpeshta të tyre. Nga ana tjetër, sot disponohet një informacion shumë më i plotë, i saktë për të gjithë basenin ujëmbledhës dhe në kohë reale. Rregullorja e vitit 1988 është hartuar në një kohë kur mungonin instrumentet e monitorimit hidrometeorologjik dhe matjet kryeshin manualisht dhe parashikimet jepeshin në mënyrë të përafërt, prandaj ajo parashikonte masa shumë konservative për të zvogëluar problematikën e pasigurisë së informacionit në kohë reale.

Sot, KESH ka instaluar më së 25 stacione monitorimi hidrometeorologjikë në të gjithë basenin ujëmbledhës të lumit Drin, të cilat transmetojnë të dhëna në kohë reale online. Duke i shtuar këtij sistemi edhe stacionet në Kosovë, Mal të Zi dhe Maqedoninë e Veriut, është e mundur të përpunohen të dhënat e prurjeve maksimale në kohë reale dhe me parashikim 3–5 ditë përpara, si dhe me një orientim javor dhe mujor për tendencat e përgjithshme të ardhjes së këtyre prurjeve në rezervuarët e kaskadës së lumit Drin.

Theksojmë se rregulloret e shfrytëzimit të digave dhe rezervuarëve janë të domosdoshme. Ato duhet të bëhen nga ekspertë të fushës dhe projektuesit e këtyre veprave dhe duhet të përditësohen nga shfrytëzuesit e tyre pas analizave të hollesishme të rezultateve të matjeve të kryera në vijueshmëri dhe në përputhje me standardet teknike. Rregulloret shërbejnë jo vetëm për të vendosur kufij sigurie për këto objekte të veçanta strategjike, por edhe për të pasur një orientim të qartë në menaxhimin e situatave që krijohen gjatë ardhjes së prurjeve maksimale të ujit.

Një tjetër faktor që sjell nevojën e përditësimit të rregullores janë volumet aktuale të tre rezervuarëve të kaskadës së lumit Drin. Rezervuari i HEC Fierza, për shembull, është projektuar 2.7 miliardë metra kub, por sot volumi aktual real në këtë rezervuar është 2.3 miliardë m³ ujë. Kjo vjen nga një sërë faktorësh, duke nisur nga ardhjet e sedimenteve gjatë 45 viteve të shfrytëzimit të saj, si dhe niveli i matjeve të kryera gjatë fazës së projektimit apo përdorimi i metodave

dhe hartave të vjetra me shkallë gabimi relativisht të lartë. Të njëjtën situatë në drejtim të volumeve të ujit e kanë edhe rezervuarët e HEC Komani dhe HEC Vau i Dejës. Ndryshimet e volumeve të ujit, të konstatuara gjatë matjeve të volumeve aktuale prej afro 15–16%, kërkojnë reflektimet dhe përditësimet përkatëse në rregulloren e shkarkimit të plotave, si dhe në mënyrën e menaxhimit të këtyre prurjeve dhe shkarkimeve që duhet të kryhen.

Theksoj se rregullorja duhet të ndryshohet në funksion të rritjes së sigurisë së digës dhe jo në funksion të rritjes së prodhimit të energjisë. Kjo do të thotë që edhe menaxhimi i shkarkimeve duhet të rishikohet, duke marrë në konsideratë faktorët e përmendur më sipër, zhvillimet e teknologjisë së informacionit, ndryshimet klimatike, si dhe monitorimin në kohë reale online të prurjeve dhe reshjeve në të gjithë zonën e basenit ujëmbledhës të lumit Drin.

A janë tejkaluar ndonjëherë prurjet maksimale nga ajo që parashikon rregullorja për kaskadën e Drinit?

Deri më sot, jo. Në rastin e kaskadës së Drinit, rregullorja parashikon edhe skenarin ekstrem për prurje që mund të vijë një herë në 10 mijë vjet, e cila ka qenë e llogaritur në një vlerë prej 9 600 m³/sekondë. Madje, eksperti hidrolog, që ka marrë pjesë në hartimin e saj, ka shënuar se duke marrë parasysh rëndësinë e jashtëzakonshme të digës së HEC Fierzë, pasojat katastrofike që mund të vijnë nga prishja e saj, si dhe faktin që të dhënat hidrologjike për përcaktimin e prurjeve maksimale në Fierzë janë më pak të sigurta, plotat kontrollouese me përsëritje 1 herë në 10 000 vjet për periudhën Tetor - Prill janë rritur me 25% kundrejt asaj të llogaritur.

Dëshiroj të theksoj se gjatë menaxhimit të prurjeve maksimale në të gjithë kaskadën e Drinit problemi më i madh nuk janë prurjet maksimale që vijnë në rezervuarin e HEC Fierza, por prurjet maksimale që vijnë në rezervuarin e HEC Komani, sepse ka një rezervuar rreth pesë herë më të vogël se Fierza, ndërkohë që prurjet maksimale mund të jenë të afërta me ato që vijnë në rezervuarin e HEC Fierzë. Në rastin e prurjeve që erdhën gjatë këtij muaji, në HEC Fierzë ishin afro 2400 m³/s, ndërsa në HEC Koman ishin më se 1200 m³/sek. Duhet pasur parasysh se në rezervuarin e HEC Komani shkarkojnë ujërat rreth 13 lumenj dhe përrenj të cilët kalojnë në një zonë malore, që është mjaft problematike për sa u përket sasive dhe intensitetit të reshjeve. Në këtë zonë është edhe

Thethi, e ashtuquajtura “njollë e zezë” e reshjeve, ku ka pasur raste që kanë shkuar deri në 300 mm shi në ditë. Siç e thashë më lart, në rezervuarin e HEC Komani u shkarkuan rreth 1 200 metra kub, pra dy herë më pak se në Fierzë, por duke qenë se volumi i këtij rezervuari është 5 herë më i vogël, ishte normale që nga HEC Komani duhet të hapeshin portat e shkarkimit dhe të kryhej shkarkimi i kontrolluar i prurjeve të mëdha. Edhe vetë mënyra si u menaxhua situata bëri të mundur minimizimin e përmbytjeve në zonën e poshtme të lumit Drin, pasi portat e shkarkimit dhe turbinat në HEC Fierzë qëndruan për rreth një javë të mbyllura dhe shkarkimet u kontrolluan nga HEC Komani. Nëse nuk do të ishin digat e ndërtuara në kaskadën e lumit Drin, prurjet prej afro 3 800 metra kub do të vinin në Shkodër në gjendje të lirë dhe pasojat do të ishin shumë më të mëdha dhe të ngjashme me përmbytjet e mëdha që kanë ndodhur në vite 1962–1963, kur nuk ishin ndërtuar këto vepra të rëndësishme.

Cilat janë masat që duhet të merren për të ulur ndikimin e përmbytjeve në vend?

Përpara se të flasim për këtë, doja që filimisht të ndalemi tek ajo që na tregon e shkuara, pasi flitet për ndikimet e digave apo ndryshimeve klimatike. Dua të sjell në vëmendje përmbytjet e viteve 1962–1963, që ishin përmbytjet më të mëdha që kanë ndodhur në vendin tonë në 100 vitet e fundit dhe me reshjet më të mëdha të regjistruara. Në atë kohë nuk ishin ndërtuar digat e kaskadës së lumit Drin apo digat e lumit Devoll. Vërtet sot flasim për ndryshimet klimatike, por ende nuk kemi arritur në vlerat e reshjeve dhe prurjeve të viteve ‘62–’63. Në ato vite thuhet se u përmbytën më se 70 mijë hektarë tokë dhe përmbytja ishte aq e madhe sa thuhet që u bashkua Semani me Vjosën, Mati me Drinin, pra e gjithë zona ndërmjet këtyre lumenjve ishte e gjitha e përmbytur. Në atë kohë nuk kishte as diga, as sisteme kulluese dhe as sisteme menaxhimi modern dhe në kohë reale. Pikërisht kjo situatë detyroi qeverinë e asaj kohe që të diskutonte me specialistët dhe inxhinierët e kohës për të gjetur zgjidhjet e duhura. Së pari u ngritën institucionet teknike projektuese përkatëse. Në atë kohë filloi krijimi dhe ngritja e Institutit të Projektimit për veprat e hidroenergjetikës dhe Institutit të Projektimit për veprat kulluese dhe bonifikuese. Këto u mbështetën nga Institutet e Gjeologjisë, Gjeodezisë, Sizmikës, Hidrometeorologjisë dhe Laboratori i Kërkimeve Hidraulike (sot

Teatri Turbina), që punuan me ekipe për hartimin e projekteve dhe ndërtimin e veprave kryesore hidroenergjetike, si dhe sistemit kombëtar të kullimit dhe ujitjes. Kjo punë e specializuar dhe në ekipe të organizuara, sipas eksperiencave më të mira të kohës, çoi në sistemimin e zonave problematike për përmbytjet, si zona e kënetës së Durrësit dhe Karavatasë, zona e Nënshkodrës, si dhe shumë zona të tjera kënetore. Pas asaj situatë përmbytjesh të viteve 1962–1963 ka pasur edhe vite të tjera me prurje dhe reshje të mëdha, por masat që u morën e ulën ndjeshëm ndikimin. Duhet theksuar se vetëm në vitet ‘60–’90 janë ndërtuar rreth 95 për qind e digave, duke përfshirë këtu edhe sistemet e kullimit, ujitjes dhe kanalet bujqësore. Është një kompleks i tërë që duhet mirëmbajtur dhe monitoruar me kujdes. Bazuar në këtë përvojë, por edhe në eksperiencat e vendeve europiane, një ndër masat kryesore afatgjatë që duhet të merren janë forcimi i institucioneve teknike dhe një riorganizim i tyre, duke rregulluar dhe përcaktuar qartë detyrat e secilit, si dhe mënyrat e bashkëpunimit ndërmjet tyre. Minimizimi i pasojave që shohim sot mund të arrihet vetëm duke pasur një organizim institucional të koordinuar dhe me detyra të qarta. Ministritë mund të bëjnë politikat, ndërsa zinxhiri i institucioneve teknike duhet të kryejë studime, të hartojë programe afatgjata dhe projekte konkrete në këtë fushë.

Si e kanë të rregulluar vendet e tjera aspektin e rritjes së sigurisë së digave dhe për të minimizuar pasojat që mund të vijë nga prurjet e mëdha?

Europa, ku ne synojmë të shkojmë, ka autoritete dhe agjenci të dedikuara për sigurinë e digave, me ekspertë me kohë të plotë. Italia, për shembull, me 600 diga të mëdha, ka një Autoritet pranë Ministrisë së Infrastrukturës me afro 120 specialistë që ushtrojnë kontrollin e shtetit në digat ekzistuese dhe miratojnë projektet e reja në këtë fushë, pavarësisht pronësisë private që kanë këto diga. Në Zvicër, me afro 220 diga të mëdha, ka një autoritet të sigurisë së digave me afro 20 ekspertë të fushës që kryejnë të njëjtën funksion si në Itali apo Francë. I njëjti organizim është edhe në afro 15 shtete europiane që kanë diga të mëdha. Në Shqipëri, me 350 diga të mëdha, mungon një institucion i tillë ekzekutues.

Si është e copëzuar përgjegjësia sot sa u takon institucioneve kontrolluese dhe monitoruese?

Sot në Shqipëri, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të funksionojë Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM), i cili është një organ shtetëror i Këshillit të Ministrave që ushtron kontrollin për sigurinë e digave në vendin tonë. Ky Komitet funksionon në formën e një bordi teknik me kohë të pjesshme dhe me anëtarë përfaqësues të disa ministrive kryesore. Funksionimi i KKDM mbështetet në një ligj të fortë që përcakton shumë detyra për këtë institucion, pa marrë parasysh mënyrën e funksionimit të tij. Ndër këto detyra përfshihen edhe kontrolli vjetor, 5-vjeçar dhe 10-vjeçar i 350 digave të mëdha, edhe miratimi i projekteve për digat e reja dhe për rehabilitimin e digave ekzistuese, edhe komunikimi i vazhdueshëm me 65 shfrytëzuesit e digave, edhe raportimet për Këshillin e Ministrave, si dhe përfaqësimi i Shqipërisë në ICOLD dhe në institucionet ndërkombëtare në sektorin e digave. Duhet thënë se, me gjithë këto detyra të shumta të rëndësishme në sektorin e digave, aktualisht KKDM nuk po funksionon prej më se 5 muajsh për shkak të mosemërimit të Kryetarit dhe nënkryetarit të këtij Komiteti, si dhe të anëtarëve të Këshillit teknik pranë KKDM. Sipas ligjit në fuqi, KKDM duhet të mbështetet nga një Inspektorat teknik nën varësinë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, por që aktualisht ky Inspektorat përbëhet vetëm nga një person, në një kohë që grupi i inspektimit në terren duhet të jetë të paktën 3 persona. Sipas eksperiencave të vendeve europiane të përmendura më sipër, mendoj se është e nevojshme krijimi i një Autoriteti apo agjencie ekzekutive për kontrollin shtetëror të digave, dambave dhe argjinaturave. Kjo agjenci duhet të ketë në përbërje të saj një ekip prej jo më pak se 20 inxhinierësh hidroteknikë, ndërtimi, gjeodet, gjeologë dhe gjeoteknikë. Ky Autoritet duhet të ushtrojë kontroll të vazhdueshëm të gjendjes dhe monitorimit të digave ekzistuese, të kontrollojë



dhe miratojë projektet për digat e reja dhe projektet për rehabilitimin e digave ekzistuese, si dhe të gjitha kërkesat e përcaktuara në ligjin për sigurinë e digave. Ky autoritet mund të jetë nën Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë ose nën varësinë e një agjencie të Këshillit të Ministrave, por duhet të ketë kompetenca të qarta kontrolli dhe detyra konkrete, si dhe të mbështetet me masat përkatëse ndëshkuese për subjektet që nuk zbatojnë kërkesat e ligjit. Duhet theksuar se monitorimi i digave nga pushtetet lokale është shumë i mangët dhe me mungesa të theksuara të kapaciteteve teknike, njerëzore dhe të sistemeve të monitorimit.

Cilët janë kriteret kur vlerësojmë riskun e një dige të ujitjes?

Vlerësimi i digave, përfshirë edhe digat e ujitjes, bazohet në katër kriterë kryesore të riskut: lartësia e digës, volumi i ujit e rezervuarin e krijuar nga diga, numri i njerëzve të rrezikuar për humbje jete në zonën poshtë digës, vlera e dëmeve që mund të shkaktohen nga shkatërrimi i digës. Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha ka realizuar një studim vitin e kaluar, sipas të cilit 50 diga rezultojnë me risk të lartë dhe 100 me risk të moderuar. Në total, për 150 diga ka risk për njerëzit që ndodhen në zonat urbane poshtë këtyre digave. Në këto diga dhe zonat urbane poshtë tyre është e domosdoshme instalimi i sistemeve të alarmit për të pasur njoftim në kohë reale për rritjen e nivelit të ujit mbi nivelin e lejuar dhe deri te njoftimi për rastin e dëmtimit apo prishjes së mundshme të digës. Në këtë drejtim, theksojmë se problemi i mungesës së këtyre sistemeve ekziston te digat e ujitjes dhe digat furnizimit me ujë të pijshëm, ndërsa digat që përdoren për prodhim hidroenergjetik janë relativisht të monitoruara. Digat e ujitjes që shfrytëzohen dhe janë nën administrimin e pushtetit vendor kanë më shumë probleme në drejtim të mirëmbajtjes dhe

monitorimit të tyre për shkak të mungesës së kapaciteteve teknike, njerëzore dhe financiare. Të njëjtat probleme janë edhe në 7 digat e mëdha dhe rezervuarë që shfrytëzohen nga 4 bordet e ujitjes dhe kullimit nën varësinë e Ministrisë së Bujqësisë, të cilat nuk monitorohen dhe nuk kanë sisteme alarmi.

Si mund të nxiten kapacitetet njerëzore, pasi shumë sektorë po hasin probleme sa u takon profesionistëve?

Është e vërtetë që kapacitetet njerëzore për kontrollin dhe monitorimin e digave dhe të rezervuarëve të ujitjes në përgjithësi mungojnë. Që nga viti 2015, kur u bë kalimi i shfrytëzimit dhe administrimit të digave të ujitjes te pushteti lokal, nuk është organizuar asnjë trajnim i specialistëve dhe punonjësve që monitorojnë digat në lidhje me kërkesat ligjore për sigurinë e digave, monitorimin e sigurisë së tyre përmes instrumenteve, zbatimin e planeve të gatishmërisë në rastet e emergjencave civile, etj. Rritja e këtyre kapaciteteve, mendoj se duhet adresuar në dy drejtime. Së pari, duhet të nxitet formimi i inxhinierëve hidroteknikë në universitete. Së dyti, është e domosdoshme të kryhen trajnime për specialistët e monitorimit të digave. Duke pasur parasysh se rreth 95% e digave janë në varësi të pushtetit vendor, të cilët nuk kanë specialistë apo inxhinierë të kësaj fushe dhe nuk kanë kryer trajnime për monitorimin e digave, mendoj se është e domosdoshme të ketë inxhinierë të trajnuar për digat në çdo bashki që ka nën administrim diga. Këto trajnime mund të realizohen me periudha të shkurtra nga ekspertë të fushës, nga Ministria e Bujqësisë ose universitetet.

Çfarë mund të bëhet në lidhje me aspektet institucionale, strategjitë dhe investimet për të minimizuar dëmet?

Ne kemi shumë institucione dhe dokumentacion shkresor, por ato nuk përbëjnë një sistem të plotë të integruar dhe funksional. Dokumente shkresore, udhëzime, vendime apo plane afatgjata për shfrytëzimin dhe kontrollin e digave janë hartuar me shumicë, por problemi kryesor mbetet zbatimi në terren i këtyre udhëzimeve dhe vendimeve. Si shembull mund të përmenden planet e gatishmërisë në rastet e emergjencave civile apo planet e menaxhimit të baseneve ujore të lumenjve kryesorë të vendit tonë, të cilat janë mjaft të rëndësishme dhe të domosdoshme, por për vetë kom-

pleksitetin e zbatimit të tyre dhe kushtet aktuale kanë hasur në shumë probleme të zbatimit të tyre.

Siç u përmend më sipër, një çështje mjaft e rëndësishme që duhet të marrë vëmendjen e duhur është kryerja e një reforme të plotë institucionale, organizative dhe ligjore në sektorin e sigurisë dhe monitorimit të digave sipas eksperiencave të vendeve europiane. Përpara se të shkohet drejt investimeve apo strategjive përkatëse në sektor, duhet të bëhet një evidentim i situatës dhe problematikave të sektorit. Sipas një studimi të mbështetur nga KKDM rezultoni se afro 10% e digave të mëdha janë jashtë funksionit për arsye të ndryshme. Ka më se 4 vjet që është kërkuar të bëhet një evidentim i plotë i problematikave dhe masave që duhet të merren për sigurinë e 400 digave të ujitjes, por ende nuk ka filluar ky proces. Një problem tjetër që ende nuk ka gjetur zgjidhje është mungesa e Kadastrës së Ujit. Plotësimi i kësaj kadastre me bazën e të dhënave për sipërfaqet ujore dhe volumen e ujit në 650 rezervuarë është një urgjencë që duhet të fillojë sa më shpejt. Akoma edhe sot, nuk janë regjistruar dhe matur sipërfaqet ujore të rezervuarëve të krijuar nga digat e ujitjes. Kjo detyrë duhet të realizohet nga pushteti lokal që i ka në shfrytëzim dhe administrim këto diga. Në bashkëpunim me pushtetet lokale, Agjencia e Menaxhimit të Ujërave duhet të fillojë plotësimin e Kadastrës së Ujit për rezervuarët artificialë në bazë të programit dhe projektit të nisur që prej më se 5 vitesh. Plotësimi i kësaj kadastre ujore është mjaft i rëndësishëm për menaxhimin real të këtyre rezervave ujore të krijuara, si dhe për zbatimin e planeve të menaxhimit të burimeve ujore, mjaft të rëndësishme në sektorin e bujqësisë, energjisë, urbanizimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet. Investimi në këtë sektor, mendoj se duhet të fillojë tek “truri”, pra tek ekspertiza, evidentimi profesional i problematikave dhe gjendjes aktuale përmes një monitorimi bashkëkohor, dhe më pas tek investimet fizike. Në vendin tonë, një ndër problemet është neglizhenca e institucioneve ndaj monitorimit të duhur në sektorin e digave dhe mungesa e zbatimit të programeve dhe planeve të përgatitura nga specialistët. Prioritet është riorganizimi i institucioneve ekzistuese që lidhen me këtë fushë. Më pas, në bazë të studimeve dhe konsulencave të duhura, duhet të planifikohen investimet. Informacioni i saktë është baza për investime të drejta dhe efikase. ■